


Zona e projektit është në një zonë që lidh tre komuna Fushe Kosova, Obiliq dhe kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Në Figurën 1 paraqitet vendndodhja e zonës së projektit, e përbërë nga zona e galeritve të mbushura të minierave, zona me vijën e gjelbër është djerrina dhe zona me vijë të verdhë është ish deponia e hirit e cila nuk është e përfshirë në këtë projekt.



Rajoni përreth është i pasur me linjit dhe është përdorur si burim energjie për termocentralet lokale të qymyrit gjatë 50 viteve të fundit. Zonat përreth djerrinës janë minuar për linjit. Zonat tjera përreth janë përdorur gjithashtu për të hedhur mbetjet e hirit nga termocentralet e qymyrit.





Figura 2. Zona me djerrinë e KEK-ut, me Deponine e Hirit A në kufirin e saj lindor. Shtojca 3 përmban të njëjtën figurë me pamje më të detajuara.

Lokacioni i djerrinës së KEK-ut ka ardhur si pasojë e deponimit të djerrinës nga ish-mihjet e linjitit në afërsi. Djerrina është formuar nga materialet e gërmuara nga një ekskavator rrotullues. Djerrina u depozitua në tokat e mëparshme bujqësore përmes një rripi transportues. Depozitimi nga një rrip transportues përzier materialet e ndryshme të tokës që u hoqën gjatë minierave të linjitit. Topografia origjinale e vendit përbëhej nga një zonë me kodra të shumta. Djerrina e depozituar u rrafshua përsëri duke përzier materialet e tokës. Pasi që u rrafshua djerrina, një shtresë e dytë u hodh sipër saj. Kupola eventuale e djerrinës u profilizua para se të arrihej lartësia e saj aktuale. Këto operacione rezultuan në një kupolë heterogjene të djerrinës.

Banorët lokalë kanë depozituar gjithashtu mbetje ndërtimi dhe mbeturina të ngurta shtëpiake midis kodrave, megjithatë sasia e mbeturinave të depozituara është e kufizuar pasi djerrina e KEK-ut është larg nga zonat më të afërta urbane. Hedhja, rrafshimi dhe profilizimi u zhvilluan gjatë një periudhe disa vjeçare. Deponia e Hirit A ka hedhur hirin nga termocentrali i afërt me qymyr, që përdorte mihjet lokale të linjitit. Ngaqë hiri ishte jo i paketuar për një periudhë të gjatë, erozioni eolik (erës) mund të ketë depozituar hirin në djerrinë. Erozioni eolik u zvogëlua qëllimisht nga KEK, e cili shkarkoi ujë nga uzina e tharjes së linjitit në deponinë e hirit. Uji ngurtësoj shtresën e sipërme të hirit duke rezultuar në një sipërfaqe më pak të ndjeshme ndaj erozionit eolik. Uji i shkarkuar përmbante Fenol.

Për të identifikuar dhe vlerësuar siç duhet nëse zona është e përshtatshme për rehabilitim dhe rikultivim, KEK së bashku me INKOS dhe TAUW (Hollandë) bënë një analizë të mostrave të tokës dhe ujërave nëntokësore, ku rezultatet e mostrave janë paraqitur më poshtë:




Nga rezultatet e fituara, siç shihet dhe në hartë, pikat e ndotura janë identifikuar me ngjyra të verdha, portokalli dhe të kuqe. Niveli i ndotjes në pikat me ngjyrë gri dhe verdhë është i ulët dhe nuk ka nevojë për masa rehabilituese, ndërsa pikat e identifikuara në ngjyrë portokall dhe të kuqe kërkojnë disa masa në mënyrë që parku të jetë gati për përdorim publik. Bazuar në një hetim të gjerë dhe modele ndërkombëtare të rrezikut (Hollandeze), nuk ekzistojnë rreze për shëndetin e njeriut që lidhen me zonën ku është djerrina. As tani dhe as në të ardhmen kur zona të funksionojë si park.

KEK dëshiron të rindërtojë zonën në një park publik me një koncept qetësie. Rehabilitimi dhe zhvillimi i parkut do të ndjekë dy faza. Faza e parë përfshin rehabilitimin e galerive të mbushura të minierave dhe faza e dytë rehabilitimin e zonës me djerrinë. Për fazën e dytë duhet të vendoset një marrëveshje me pronarët e ndryshëm të tokave.


Tabela më poshtë jep një shpjegim mbi funksionin e secilit sektor të parkut, i cili është i ndarë në bazë të cilësisë së përdorimit të tokës.

Elementi	Funksioni	Zona në ha	Pjerrësia mesatare
1	Gjelbërim -ripyllëzim	3,0	5,5
2	Gjelbërim -ripyllëzim	2,1	3,5
3	Gjelbërim -ripyllëzim	7,4	4,2
4	Fusha sportive	2,3	4,6
5	Gjelbërim -ripyllëzim	5,7	5,1
6	Gjelbërim -ripyllëzim	11,1	6,3
7	Parking	2,8	6,2
8	Gjelbërim -ripyllëzim	6,5	6,3
9	Gjelbërim -ripyllëzim	3,7	5,1
10	Parking	1,0	8,4
11	Gjelbërim -ripyllëzim	9,3	7,0
12	Biznese të vogla	3,4	4,6
13	Gjelbërim -ripyllëzim	5,6	6,1
14	Gjelbërim -ripyllëzim	3,9	4,5
15	Parking	3,1	8,2
16	Qendra rekreative dhe sportive	7,2	5,6
17	Gjelbërim -ripyllëzim	14,9	5,8
18	Gjelbërim -ripyllëzim	2,1	7,6
19	Parking	1,2	7,3

Ndërsa harta më poshtë shpjegon sektorët dhe zonën që do të mbulojë secili sektor dhe pjerrësinë e lokacionit.



Ngaqë terreni është në pjerrësi, ka pasur një propozim nga ekspertet e TAUW që të zgjidhet problemi i rrjedhjeve të ujit, në menyrë që të lehtësohet drenazhimi i ujërave të shiut pa shkaktuar ndonjë dëm në park. Shigjetat shpjegojnë se si rrjedhja e ujit do të lëvizë drejt pellgjeve të vogla, të formuara natyrshëm në fund të deponive të hirit, të cilat përveç kësaj do të ofrojnë edhe atraksion për përdoruesit e parkut.




Gjatë hartimit të parkut, KEK dhe ekspertë ndërkombëtarë (TAUW) kanë menduar të shfrytëzojnë sa më mirë lokacionin, ku sektorët me cilësi më të ulët të tokës, u propozuan të shërbenin si vendparkime për përdoruesit e parkut të cilët vijnë me makina. Kjo është ilustruar në hartën më poshtë:



Fotografia / figura e fundit ilustron se si do të trajtohet uji i ndotur me ndihmën e bimëve speciale (fitosmediation).

- ← Contaminated groundwater
- ← Slightly contaminated groundwater
- ← Clean groundwater



## Konkluzione

- E gjithë zona që lidh tre komuna, Fushe Kosova, Obiliq dhe Prishtina do të rindërtohet në një park publik. Parku do t'i shërbejë komunitetit në afërsi të zonës së projektit, por vendet e parkimit gjithashtu do të lejojnë qasje për njerëzit nga zonat më larg. Parku do të ketë një koncept qetësie ku argëtimi dhe sporti do të jenë koncepti kryesor i vizitorëve. Asnjë tubim publik në shkallë të gjerë (d.m.th. koncerte, festivale etj) nuk parashikohet.
- Rehabilitimi dhe zhvillimi i parkut do të ndjekë dy faza. Faza e parë përfshin rehabilitimin e galerive të mbushura të minierave dhe faza e dytë rehabilitimin e zonës me djerrinë. Për fazën e dytë duhet të vendoset një marrëveshje me pronarët e ndryshëm të tokave.
- Dheu do të ripërdoret në zonën e projektit, kur është e mundur. Transporti në shkallë të gjerë jashtë lokacionit i dheut nuk është parashikuar. Përrjashtim nga kjo bën toka e djegur në djerrinë.
- Nuk do të ketë ndërtime të përhershme mbi djerrinë ose galeritë e mbushura të minierave. Toka me djerrinë thjesht nuk ka kapacitet të mjaftueshëm mbajtës. Çdo ndërtesë që do të ndërtohet mbi këtë zonë duhet të jetë prej materialeve të lehta (d.m.th. çeliku ose druri).
- Ujërat nëntokësore të kontaminuar burojnë nga liqeni i katranit nën deponinë aktuale të hirit dhe aktualisht nuk levizin.
- Minierat e mbushura në përgjithësi janë shembur. Shembjet e mëtejshme të minierave në shkallë të gjerë nuk parashikohen. Megjithatë shembje me shkallë të vogël nuk duhet përjashtuar.
- Mbeturinat e hedhura në mënyrë të paligjshme përbëhen nga mbeturinat e ngurta komunale dhe ato të ndërtimit, asnjë mbeturinë kimike, industriale apo spitalore nuk është hedhur në zonë.

